



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 8746 Prot.

Lezhë, më 20/05 /2022

PROJEKT VENDIM

Nr. —, datë 20/05, 2022

**PËR
MIRATIMIN NË PARIM TË VËNIES NË DISPOZICION TË PASURIVE, FONDIT TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE
STRATEGJIKE, MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe 1.2 shkronja "c", nenit 54 shkronja "e" dhe nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 28, pika 2, të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative", ligjit Nr.8743 datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", Kreut II të Vendimit Nr. 1030, datë 16.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe formën e pjesëmarrjes së shtetit në investimet strategjike dhe rregullat për krijimin, funksionimin e administrimin e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike", Këshilli Bashkiak, Vendimit nr 11/6, date 04.02.2021, shkreses se ASHK Lezhe nr 539/1 Prot date 14.04.2022

PROPOZOJ

1. Dhenien e pëlqimit për transferimin e pasurive (me koordinatat sipas aneksit 1 bashkëngjitur), të cilat janë në administrim të Bashkisë Lezhë, kundrejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
2. Dhënien e pëlqimit për propozimin dhe kalimin e pasurisë në "Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike";
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë për kryerjen e procedurave ligjore të transferimit të pasurive të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi;
4. Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 97, date 28.05.2021 shfuqizohet;
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

**KRYETARI
PJERIN NDREU**

